
REFERATE E KUMTESA

VASIL KRISTO**RRETH ARSIMIMIT GJEOGRAFIK NË SHKOLLAT SHQIPE
NË PERIUdhËN 1887-1912**

Në këtë referat jemi përpjekur që në bazë të teksteve gjeografikë të botuara, të gjykojmë se çfarë mësonin nxënësit në lëndën e gjeografisë në shkollat shqipe gjatë kësaj periudhe, cilat ishin njohuritë që ata merrnin, cili ka qenë horizonti e niveli gjeografik si dhe përmbajtja shkencore e tyre, çfarë vendi zinte gjeografia e vendit tonë, çfarë roli kanë luajtur botimet gjeografike të kësaj periudhe në arsimimin gjeografik shqip dhe në edukimin patriotik të nxënësve.

*

* *

Gjeografia, si lëndë mësimore në shkollat shqipe filloi të jepej që me çeljen e Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë më 1887. Ajo zhvillohej në të gjitha vitet. Sipas studiuesit prof. H. Myzyri, në Shkollën Shqipe të Korçës, të djemve, për vitin shkollor 1900-1901, gjeografia jepej në klasën e III, IV, V dhe VI, kurse në shkollën e vajzave po në këtë vit shkollor qysh në klasën e parë jepej gjeografia e Shqipërisë dhe në klasën e dytë jepej së bashku histori dhe gjeografi e Shqipërisë. Në klasën e tretë dhe të katërt zhvillohej histori dhe gjeografi e përgjithshme. Me çeljen e Normales së Elbasanit më 1909, gjeografia filloi të zhvillohej edhe aty, dhe ishte një nga lëndët mësimore të rëndësishme. Për rilindësit e vendit tonë, gjeografia ka qenë një nga lëndët kryesore për arsimimin e nxënësve. Ajo radhitej së bashku me gjuhën, aritmetikën dhe historinë.

Për rëndësinë që i kushtonin lëndës së gjeografisë, krahas teksteve të tjera shkollore, në atë periudhë u hartuan dhe tekstet e gjeografisë. Duke filluar që nga shkrimet gjeografike të S. Frashërit të botuar në “Alfabetaren e Gjuhës Shqipe” më 1879 dhe deri në Shpalljen e Pavarësisë së vendit më 1912, janë hartuar disa libra gjeografikë ndër të cilët janë “Dheshkronja” e S.Frashërit më 1888 dhe “Dituritë” e N.Frashërit botuar po më 1888. Më vonë botohen libra të tjerë gjeografikë si “Dheshkroie” (e përmbledhme me pak fjalë për Msoitore t’Shcypniis), libri “Shcypnia” botuar në Shkodër më 1902, si dhe “Dheshkroje” e G.Mikelit botuar në Shkodër më 1912, etj. Një ndihmesë të madhe në

zgerimin e njohurive gjeografike kanë dhënë edhe dy botimet e mëposhtme: “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” e S.Frashërit botuar më 1899 dhe “Korça dhe pshatrat përçark” e N.Naçit botuar më 1901.

“Dheshkronja” e S.Frashërit dhe “Dituritë” e N.Frashërit kanë qenë tekstet e para bazë në gjuhën shqipe që u përdorën në mësonjëtoret shqipe për një periudhë të gjatë. Ato kanë luajtur një rol të madh në arsimimin gjeografik në shkollat shqipe të kësaj periudhe. Për të parë se çfarë studiohej në lëndën e gjeografisë në këto shkolla dhe cili ishte niveli shkencor e metodik i saj (gjeografisë), po njihemi në fillim me përmbajtjen e “Dheshkronjës” së S.Frashërit e në vazhdim me tekstet e tjerë.

Libri “Dheshkronja” e S.Frashërit përmban të dhëna gjeografike nga fusha e gjeografisë fizike, ekonomike dhe politike. Ai është një tekst i mirëfilltë gjeografik si në përmbajtje, paraqitje e trajtim dhe përfaqëson një tekst gjeografik të përgjithshëm. Në këtë aspekt ai është i njëjlojtë me tekstet gjeografike shkollore të asaj kohe, të botuara në vendet e tjera evropiane.

Si të gjithë tekstet shkollore dhe “Dheshkronja” e S.Frashërit fillon me objektin e saj. S.Frashëri e ka përcaktuar shumë qartë e shkurt objektin e saj: “*Dheshkronja është dituri e faqes së Dheut*”¹.

Ky libër përbëhet nga tre kapituj.

Në pjesën e parë e të dytë, të kapitullit të parë, jepen konceptet kryesore të gjeografisë fizike të përgjithshme dhe gjeografisë fizike krahinore. Në fillim trajtohen forma e Tokës si sferë e shtypur në të dy polet, boshti i Tokës, polet, meridianët, paralelet, ekuatori, rrathët polarë, tropikët, gjerësia e gjatësia gjeografike e përcaktimi i tyre nëpërmjet gradëve (shkallëve sipas S.Frashërit), hemisferat, brezat e nxehtësisë me veçoritë e tyre, horizonti, etj. Mandej trajtohen konfiguracioni i sipërfaqes së rruzullit tokësor dhe ndarja e tij në kontinente (copa sipas S.Frashërit) si dhe konceptet më të përgjithshme si ç’janë oqeanet, detet, gjiret, ngushticat, kontinentet, gadishujt, ishujt, malet e vargjet malore, pllajtat, fushat, shkretëtirat, oazet (gjelbëroret sipas S.Frashërit), liqenet, lumenjtë, etj. Jepen gjithashtu veçoritë e tyre dhe rëndësia gjeografike që ato kanë. Për nxënësit këto njohuri e koncepte kanë qenë të mjaftueshme e të kapshme, duke krijuar mundësi reale për t’u përvetësuar e kuptuar objektet dhe dukuritë fiziko-gjeografike. Ajo që bie në sy është fakti se të gjitha këto njohuri e koncepte në “Dheshkronjën” e S.Frashërit shprehen me saktësi shkencore që edhe sot e ruajnë vlerën.

Në pjesën e tretë deri në të gjashtën e këtij kapitulli shtjellohen racat, kombet, besimet fetare, sistemet shtetërore e llojet e qeverive. Këto dukuri sot janë objekt i studimit të gjeografisë ekonomike të përgjithshme.

¹ Sami Frashëri, *Dheshkroje*, Bukuresht, 1888, f. 3.

Kapitulli i dytë bën fjalë për Evropën. Problemet që trajtohen në këtë kapitull janë objekt i gjeografisë regjionale (trajtohen probleme fizike, ekonomike, politike, etj.).

Në pjesën e parë të këtij kapitulli jepen karakteristikat fiziko-gjeografike të Evropës duke trajtuar me radhë kufijtë e saj, ndarjen sipas krahinave fiziko-gjeografike, ujërat që e lagin, (detet, gjiret, ngushticat), relievin (malet, fushat, etj.), lumenjtë, liqenet, etj. Edhe këtu materiali i paraqitur është i bollshëm, i dhënë në mënyrë sistematike dhe me saktësi të madhe. Për të gjitha objektet gjeografike jepen veçoritë e tyre, pozita gjeografike ku ndodhen si dhe raporti që ato kanë me objektet e tjera gjeografike. Në vazhdim të këtij kapitulli trajtohet popullsia e Evropës, si ndahet ajo sipas besimeve fetare, trajtohen kushtet klimatike, tregtia që bën Evropa me kontinentet e tjera, etj. Në këtë pjesë përcaktohen veçoritë origjinale të Evropës që e dallojnë atë nga kontinentet e tjera. P.sh. në të shkruhet: “ *Evropa me që nuk ka shkretëtira dhe klima e saj është nga më të mirat, që nuk bën as shumë nxehtë as fort ftohtë, është më e punuar, më e ndërtuar dhe më e zbukuruar nga të gjitha copërat (kontinentet) e Dheut*”²..... Më tej vazhdohet: “ *gjithë dituritë e mjeshhtëritë janë mbledhur në këtë copë dhe së andejmi ndrihenë (ndriçojnë) përmbi gjithë anët e Dheut*”³.....etj.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli trajtohen me radhë shtetet që ekzistonin në atë periudhë në Evropë. Më gjatë, kuptohet, trajtohet Britania e Madhe (Inglitera sipas S. Frashërit), Austro-Hungaria, Rusia e Turqia Evropiane, Gjermania dhe Franca. Për të gjithë shtetet trajtohen pozita gjeografike, kufijtë, madhësia, kushtet natyrore, popullsia, qytetet, pasuritë minerare, prodhimi bujqësor, niveli ekonomik, transporti, tregtia, kolonitë (për ato shtete që kishin), etj. Duke u ndalur për secilin shtet, theksi është vënë në ato dukuri e objekte që e dallojnë shtetin përkatës nga të tjerët. Kështu p.sh., duke përmendur zhvillimin e madh të transportit të Anglisë në “Dheshkronjë” shkruhet: “ *Inglitera është e përçarë me vija(kanale) e me lumenj nëpër të cilët punojnë anije, edhe me udhë hekuri të shumta, të cilat lehtësojnë e shumojnë tregëtinë*”⁴..... Kurse për Londrën shkruhet: “ *është kryeqyteti më i madh e më i pasuri i gjithë kryeqyteteve të Evropës mbi lumin Tamiza*”⁵.....

Trajtimi në këtë mënyrë i shteteve të veçantë e ka bërë “Dheshkronjën” që të mos jetë monotone dhe njohuritë që jepen në të për çdo shtet të kuptohen e mbahen mend më mirë nga nxënësit. Kjo është shumë e rëndësishme po të kemi parasysh që nxënësit e kanë të vështirë që vetë ata të përqendrohen në atë ç’është më kryesore.

² *Po aty*, f. 24-25.

³ *Po aty*, f. 25-26.

⁴ *Po aty*, f. 31-32.

⁵ *Po aty*, f. 28.

Pjesën e tretë të këtij kapitulli e përbën gjeografia e vendit tonë e cila zë rreth 15% të tekstit.

Në kapitullin e tretë trajtohet kontinenti i Azisë. Renditja e materialit për këtë kontinent dhe mënyra e trajtimit është e njëjtë si dhe për kontinentin e Evropës. Edhe për Azinë janë nxjerrë më në pah ato dukuri e veçori që janë më karakteristike për të.

Në “Dheshkronjën” e S.Frashërit nuk trajtohen kontinenti i Afrikës, Amerikës Veriore e Jugore dhe ai i Australisë. Kjo ndoshta se këto kontinente trajtoheshin në librin “Dituritë” e N. Frashërit.

Krahas “Dheshkronjës” së S.Frashërit, siç e përmendëm më lart, një vend të rëndësishëm në arsimimin gjeografik të nxënësve në shkollat shqipe të kësaj periudhe, kanë luajtur edhe shkrimet e N.Frashërit të trajtuara në revistën (tekstin) “Dituritë”. Megjithëse në këtë libër (revistë) vetëm një kapitull titullohet “Dheshkronja”, ndërsa kapitujt e tjerë u përkasin dijeve të tjera si fizika, kimia, astronomia, etj., edhe në këta kapituj gjejmë të dhëna të shumta gjeografike nga të gjitha sferat ose fushat e gjeografisë. Njohuritë gjeografike janë shpërndarë gati në të gjithë kapitujt, dhe kjo është e kuptueshme mbasi gjeografia lidhet e ndërthuret me këto shkenca dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në të kuptuarit e dukurive përkatëse. E krahasuar me “Dheshkronjën” e të vëllait (Samiut) gama e koncepteve gjeografike në librin e N.Frashërit, “Dituritë”, është më e gjerë. Vetëm kapitulli “Dheshkronja” i përgjigjet librit të S.Frashërit “Dheshkronja”, por libri i S.Frashërit i trajton dukuritë gjeografike më gjerësisht dhe për një moshë më të rritur⁶. Qëllimi i këtyre materialeve gjeografikë të botuar nga N. Frashëri në “Dituritë” ka qenë pajisja e nxënësve me kulturë gjeografike nga të gjitha sferat e saj. Kështu në kapitullin e parë “Dhetregonje”, trajtohen formimi i Tokës si planet, evolucioni i saj, epokat gjeologjike e ndryshimet që ka pësuar Toka gjatë çdo epoke, oqeanet, malet e territoret e krijuara, bimët e kafshët e shfaqura e të zhdukura, etj.

Në tekst nuk jepen vetëm faktet, por shpjegohen e sqarohen formimi i sistemit diellor, i Tokës, Hënës e planeteve të tjerë, shpjegohen arsyet pse në Hënë nuk ka jetë, si kanë ndodhur ndryshimet e Tokës deri sa ajo arriti në gjendjen e sotme, pse ka ndryshuar relievi, bota bimore e shtazore, etj. etj. Madje në të flitet gjithashtu edhe për ftohjen e klimës dhe shkaqet e kësaj ftohje të saj. Vlen të theksohet se, të gjitha këto dukuri gjeografike janë trajtuar me saktësi shkencore e kronologjike që e ruajnë vlerën edhe sot.

Në kapitullin e emërtuar “Kafshë tregonje” ndër dukuritë gjeografike që trajtohen janë ato që lidhen me ndërtimin gjeologjik të Tokës (trajtohen gjithashtu shkëmbinjtë dhe mineralet, vlerat që kanë dhe rëndësia ekonomike e

⁶ Me sa duket *Dheshkronja* e S. Frashërit duhet të jetë përdorur për vite më të larta.

tyre), dherat, bimësia e bota shtazore e sotme. Këto tre të fundit, krahas aspektit biologjik shihen dhe në aspektin gjeografik duke bërë klasifikimin e tyre, vendet ku ndodhen dhe përhapjen gjeografike.

Në kapitullin e emërtuar “Dheshkronja”, që është dhe kapitulli më i gjerë nga ana gjeografike, trajtimi i materialit është i ngjashëm me trajtimin që bëhet në shkrimet për gjeografinë në “Alfabetaren e Gjuhës Shqipe” 1879 dhe në librin “Dheshkronja” të S.Frashërit, 1888. Në këtë kapitull si dhe në “Dheshkronjën” e S.Frashërit jepen të dhëna gjeografike nga fusha e gjeografisë fizike, ekonomike e politike. Në pjesën e parë të këtij kapitulli trajtohen probleme e dukuri që i takojnë gjeografisë së përgjithshme (trajtohen forma e përmasat e Tokës, polet, meridianët, paralelet, gjerësia e gjatësia gjeografike, rrotullimi i Tokës, brezat e nxehtësisë etj.). Mandej vazhdohet me konfiguracionin e sipërfaqes së Tokës, ndarjen e saj në oqeanë e kontinente, trajtohen konceptet ishull, gadishull, male e vargje malore, det, liqen etj. Trajtohen gjithashtu popullsia duke bërë dhe klasifikimin e saj sipas zhvillimit kulturor dhe ekonomik, besimet fetare e racat dhe shpërndarja gjeografike e tyre, si dhe sistemet shtetërore. Pjesa tjetër e këtij kapitulli përmbledh të dhëna nga gjeografia regjionale e botës. Në këtë pjesë trajtohen veçoritë gjeografike për secilin kontinent të banuar nga njerëzimi. Trajtimi gjeografik i këtyre kontinenteve bëhet gati në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtat kritere si dhe në “Dheshkronjën” e S.Frashërit. Në librin e N.Frashërit në dallim nga “Dheshkronja” e Samiut, trajtohen edhe kontinenti i Afrikës, Amerikës Veriore e Jugore dhe Australia (Oqeania sipas tij). Gjatë trajtimit të kontinentit të Evropës një vend të veçantë zë gjeografia e Shqipërisë.

Në kapitullin e emërtuar “Qieleshkronje” duke përshkruar trupat qiellore, trajtohen dhe dukuritë gjeografike që ndodhin si pasojë e formës, madhësisë, rrotullimit, pozicionit të Tokës dhe vendit të saj në sistemin diellor.

Njohuri të gjera gjeografike gjejmë dhe në kapitullin e fizikës, të cilat kanë të bëjnë më tepër me atmosferën dhe hidrosferën (për ndërtimin e përbërjen e atmosferës, për erën, pse ajri lëviz e ngjitet lart, për avujt e ujit në atmosferë, për retë, si formohen ato, si formohet shiu, bora, vesa, bryma, ç’janë lumenjtë e liqenet e si formohen ata, cila është veprimtaria e lumenjve e dukuri të tjera gjeografike).

Nga sa përmendëm vëmë re se, gama e koncepteve dhe njohurive gjeografike të dhëna në librin “Dituritë” të N.Frashërit është shumë e gjerë dhe nga të gjitha fushat e gjeografisë. Të dhënat gjeografike që jepen e trajtohen në kapitullin “Dhetregonjë” dhe “Kafshëtregonjë” për ndërtimin e Tokës dhe evolucionin e saj, për ndryshimet që kanë ndodhur në relief, klimë, botë bimore e shtazore u përkasin bazave gjeologjike të gjeografisë. Kapitulli “Dheshkronja” është një kapitull i mirëfilltë gjeografik dhe njohuritë e dhëna në të u përkasin fushave të gjeografisë fizike, ekonomike, politike, të popullsisë etj. Ky kapitull ka karakter të përgjithshëm dhe regjional. Të dhënat gjeografike

të trajtuara në kapitullin “Qiellshkronjë” u përkasin njohurive gjeografike që sot i quajmë bazat astronomike të gjeografisë, kurse të dhënat gjeografike të trajtuara në kapitullin e fizikës u përkasin atyre dukurive që sot janë objekt i studimeve të gjeografisë fizike të përgjithshme. Kjo përmbajtje gjeografike e librit (revistës) “Dituritë” për mësonjëtoret e para shqipe të N.Frashërit, i pajiste nxënësit e shkollave të para kombëtare shqipe me njohuri të plota gjeografike. Kjo tregon gjithashtu sa rëndësi të madhe i jepnin rilindësit formimit gjeografik të nxënësve, jo vetëm për vende e shtete të veçanta, por për gjithë gamën e dukurive gjeografike si ato natyrore ashtu dhe ato shoqërore.

Në ndihmë të shkollave shqipe të kësaj periudhe ka shërbyer dhe teksti i titulluar “Dheshkroie” (e përmbledhur me pak fjalë për Msoitore t’Shcypniis)⁷.

Paraqitja e materialit në të ndryshon disi nga “Dheshkronja” e S.Frashërit dhe “Dituritë” e N.Frashërit. Materiali në këtë tekst është ndarë në dy pjesë dhe përbëhet nga disa kapituj e nënkapituj. Në fillim të pjesës së parë jepen të dhëna që sot u përkasin bazave astronomike të gjeografisë. Në të bëhet fjalë për trupat qiellore e Gjithësinë dhe trajtohen veçan Dielli, Toka e Hëna (Përmasat, forma e lëvizjet e Tokës, Hënës, eklipsset, etj.), gjithashtu bëhet fjalë për ekuatorin, tropikët, brezat polare, meridianët e paralelet, gjatësinë e gjerësinë gjeografike etj. Mandej jepen koncepte dhe dukuri që janë objekt i studimit të gjeografisë fizike të përgjithshme. Kështu flitet për ndarjen e rruzullit tokësor në botën e gjallë (në botën bimore e shtazore shënim - V.K.) dhe në botën e vdekur (atmosfera, hidrosfera, litosfera shënim - V.K.) dhe bëhet fjalë për atmosferën, rrezatimin diellor, temperaturat, klimën, oqeanet, baticat e zbaticat, dherat, shkëmbinjët e metalet etj. Gjithashtu bëhet fjalë dhe për nocionet fiziko-gjeografike si ç’quhet kontinent, gadishull, ishull, kepe, dete, gjire detare, ngushtica, breg, buzë deti etj. Kjo pjesë përfundon me përshkrimin e shpërndarjes së oqeanëve dhe të kontinenteve (përmenden ku ato shtrihen, hapësirat që zenë, me kë kufizohen, përmasat e tyre, etj.). Po këtu jepen të dhëna për detet e gjiret kryesore dhe ishujt të ndarë sipas oqeanëve ku ata bëjnë pjesë. Për ishujt më të mëdhenj si Grenlanda, Madagaskari, Borneo etj., jepet dhe sipërfaqja e tyre. Ky kapitull përfundon me ngushticat më të njohura (jepen të dhëna për gjerësinë e tyre, cilët dete lidhin ose cilët territore ndajnë etj.) dhe me istmet.

Në kapitullin e parë të pjesës së dytë trajtohen komponentët përbërës të kontinenteve ose të pjesës tokësore. Në fillim jepen nocionet si ç’është lartësia absolute e relative, ç’quajmë ujëra kontinentale (ç’quajmë lumenj, liqen, kënetat, ujëvara, delte lumore etj.), jepen shpjegime ç’quhet fushë, kodër, pllajë, rrafshnaltë, mal i ulët, mesatar, i lartë, dhe njëkohësisht jepen dhe lartësitë e

⁷ Libri nuk ka as autor, as vend botimi, as dhe datë botimi. Sipas shkronjave të gjuhës së përdorur, ka mundësi të jetë shkruar aty nga fundi i shek. XIX dhe me autor nga Shqipëria e Veriut.

tyre (malet me lartësi mbi 5200 m i quajnë bjeshkë). Flitet gjithashtu ç'janë vullkanet etj. Mbas sqarimit të këtyre nocioneve për komponentët përbërës të kontinenteve bëhet përshkrimi me hollësi i tyre sipas kontinenteve duke dhënë kështu veçoritë fiziko-gjeografike të kontinenteve. Si dhe në tekstet e tjerë fillohet me kontinentin e Evropës. Kështu përshkruhen me radhë malet e vargjet malore kryesore të Evropës, ku ata shtrihen, çfarë lartësi kanë, e të tjera tipare. Më gjatë trajtohen Alpet e Evropës dhe Karpatet. E njëjta gjë bëhet edhe kur përshkruhen fushat edhe pllajrat. Mandej vazhdohet me lumenjtë kryesorë, nga ata burojnë dhe ku derdhen (lumenjtë trajtohen sipas deteve ku ata derdhen) etj., si dhe me liqenet më të mëdhenj duke dhënë emërtimet e tyre dhe ku ata ndodhen. Përmenden 21 liqene të Evropës, midis tyre dhe liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit. E njëjta rrugë është ndjekur edhe gjatë përshkrimit të veçorive fiziko-gjeografike të kontinenteve të tjerë.

Kapitulli i dytë i kësaj pjese i titulluar “Dheshkroie Politike” nga mënyra e përmbajtjes dhe e trajtimit është e ngjashme me “Dheshkronjën” e S. Frashërit. Në fillim bëhet fjalë për popullsinë (jepet dhe numri sipas kontinenteve si dhe shpjegohet çfarë quhet popullsi vendase dhe popullsi e ardhur, etj.), për racat dhe ku ato janë shpërndarë, për llojet e feve, numrin që ka secila prej tyre dhe ku ato janë më të përhapura. Flitet gjithashtu për gjuhët (sipas këtij teksti njiheshin rreth 2000 gjuhë në botë) si dhe rendin shtetëror duke shpjeguar çfarë quhet mbretëri dhe republikë. Në vazhdim të këtij kapitulli trajtohen veç e veç kontinentet dhe shtetet që bëjnë pjesë në ta (jepet popullsia, qytetet, zhvillimi ekonomik, tregtia, transporti etj.). Ashtu si në “Dheshkronjën” e S. Frashërit dhe në “Dituritë” e N. Frashërit, edhe në këtë tekst trajtohen më tepër ato dukuri që janë më të veçanta për secilin kontinent e shtet. Duke folur për Turqinë Evropiane, ashtu si dhe në tekstet e tjerë, flitet gjatë dhe për gjeografinë e vendit tonë.

Një rol të madh në arsimimin gjeografik të nxënësve ka luajtur edhe teksti “Dheshkrojë për Msojtoe Popullore e Gjytetnore” me autor Gaspër Mikeli dhe botuar në Shkodër më 1912. “Dheshkrojë” e G. Mikelit është teksti më i plotë dhe më i arrirë gjeografik deri në atë periudhë. Ai është një tekst gjeografie i përgjithshëm i hartuar sipas shembujve të teksteve gjeografike që botoheshin në atë periudhë në shtetet e Evropës. Nga përmbajtja, sasia e të dhënave gjeografike dhe niveli, ky tekst ka qenë i përshtatshëm për Shkollën Normale të Elbasanit, ndoshta ka qenë hartuar për të.

Në pjesën e parë të titulluar “Dheshkroje matematike”, jepen bazat astronomike të gjeografisë. Disa nga çështjet që trajtohen në këtë pjesë janë: si janë krijuar trupat qiellorë, si ata klasifikohen dhe cilat janë veçoritë e tyre, çfarë madhësie ka Toka dhe cilat janë lidhjet e saj me trupat e tjerë qiellorë, etj. Në mënyrë shumë më të gjerë trajtohet Toka si planet. Ajo trajtohet në të gjithë gamën e saj, si qëndron në hapësirë, pse nuk përplasat me trupat e tjerë qiellorë, pse është e shtypur në të dy polet, çfarë lëvizjesh bën e çfarë pasojash linden,

ç'është boshti i Tokës, çfarë janë polet, meridianët, paralelet, gjerësia e gjatësia gjeografike dhe si ato maten e përse shërbejnë, si përcaktohet koha lokale, etj. Kjo pjesë përfundon me përshkrimin e Hënës, duke trajtuar formën, përmasat dhe ndërtimin e saj, pse mungon atmosfera në të, lëvizjet që ajo bën, si formohen baticat, etj. Njohuritë për bazat astronomike të gjeografisë të paraqitura në këtë tekst janë të shumta e të mjaftueshme për shkollat e mesme, të sistemuara dhe me analizat e shpjegimet përkatëse dhe sipas të dhënave shkencore.

Në pjesën e dytë të titulluar “Dheshkrojë fizike” trajtohen probleme që janë objekt i studimit të gjeografisë fizike të përgjithshme dhe gjeografisë fizike krahinore. Në fillim të kësaj pjese trajtohen gjeosferat përbërëse të Tokës (litosfera, hidrosfera dhe atmosfera). Ato trajtohen e studiohen në të gjithë gamën e tyre. Kështu fillohet me dhënien e koncepteve të përgjithshme fiziko-gjeografike të tilla si çfarë janë kontinentet, malet, fushat, oqeanet, detet, gjiret detare, lumenjtë, burimet, atmosfera e përbërësit e saj, etj. Mandej trajtohen forcat e brendshme dhe përcaktohen ç'janë tërmetet e vullkanet, cilët janë shkaqet e lidhjet midis tyre, cilat janë pasojat etj. Gjithashtu trajtohen e shpjegohen ç'janë valët detare, baticat e zaticat e si formohen ato, shpjegohet si bëhet avullimi i ujit të detit, si formohen retë, shiu e bora, burimet, lumenjtë e liqenet etj., si ngrohet ajri, pse ai lëviz e ngjitet lart, si formohet era, si formohen dukuritë e ndryshme në atmosferë, si bëhet qarkullimi i atmosferës, trajtohen erërat lokale si formohen, etj. Gjithashtu në “Dheshkrojen” e G. Mikelit shpjegohen për herë të parë kushtet dhe formimi i akullit dhe i akullnajave në malet e lartë dhe pse nuk ka bimësi në lartësi të mëdha. Në trajtimin e këtyre gjeosferave, jepen shumë dukuri, të dhëna e koncepte të reja që nuk i gjejmë në tekstet e mëparshme gjeografike të botuara. Në tërësi në këtë pjesë trajtohet gati e gjithë gama e dukurive fiziko-gjeografike që përfshihen sot në lëndën e gjeografisë fizike të përgjithshme. Vlen të theksohet se në tekst është bërë e mundur të përcaktohen e dalin në pah shkaqet dhe lidhjet e ndërsjella midis gjeosferave të Tokës. Kjo tregon se konceptet e reja gjeografike të fundit të shek.XIX e fillimit të shek.XX, ishin pasqyruar në tekst. Në këtë pjesë nuk trajtohet biosfera. Kjo ndoshta për faktin se nxënësit me bimësinë dhe botën shtazore njiheshin në lëndën e biologjisë dhe të zoologjisë; ndoshta dhe për mendimin që ekzistonte në atë kohë në një pjesë të gjeografëve, se gjeografia duhet të merret vetëm me pjesën jo të gjallë të Tokës. Sidoqoftë njohuritë për litosferën, hidrosferën dhe atmosferën, për dukuritë e proceset që ndodhin në to të paraqitura në tekst i japin të plota veçoritë fiziko-gjeografike të rruzullit tokësor në tërësi dhe të komponentëve përbërës të tij në veçanti si dhe lidhjet e ndërsjella që ekzistojnë midis tyre.

Në gjysmën e dytë të kësaj pjese që ka karakter regjional, trajtohen veçoritë fiziko-gjeografike të secilit kontinent duke u ndalur kryesisht në tiparet e jashtme, në relievin dhe hidrografinë e kontinenteve. Mënyra e trajtimit për të

gjithë kontinentet është e njëjtë dhe pothuajse në atë strukturë si dhe te “Dheshkronja” e S. Frashërit dhe tekstet e tjera.

Pjesa e tretë e titulluar “Dheshkroje politike” përmban elementë të gjeografisë ekonomike të përgjithshme dhe elementë të gjeografisë së shteteve. Në fillim të kësaj pjese trajtohen problemet e përgjithshme të popullsisë si numri i saj në botë e sipas kontinenteve, racat njerëzore, besimet fetare, gjuhët, rendi shtetëror (flitet për shtetet që bëjnë pjesë në Evropë, gjuhët që përdorin, fetë që kanë, kombet që banojnë, nivelin kulturor e ekonomik, etj.) etj. Mënyra e trajtimit është po ajo e autorëve shqiptarë të mëparshëm, por duke e azhurnuar me të dhënat e konceptet e kohës. Po në “Dheshkroje politike” trajtohet gjerësisht dhe gjeografia e vendit tonë.

Një vend të veçantë në arsimimin gjeografik në shkollat shqipe zinte dhe gjeografia e vendit tonë. Në të gjithë tekstet e përmendur bëhet fjalë për gjeografinë e vendit tonë (në të gjithë tekstet ajo zinte gati rreth 1/3 e materialit të çdo teksti), madje në vitin 1902 në Shkodër u botua edhe një tekst i veçantë për gjeografinë e vendit tonë i titulluar “Shcypnia”⁸.

Më gjerësisht gjeografia e vendit tonë trajtohet në tekstin e G. Mikelit dhe në librin “Shcypnia” dhe pastaj në “Dheshkronjën” e S.Frashërit. Në të gjithë tekstet trajtohen veçoritë fiziko-gjeografike (detet që e lagin, gjiret, kepet e vija bregdetare, malet e fushat, lumenjtë, liqenet, klima etj.), ndarja administrative, popullsia e qytetet, ekonomia (gjendja e bujqësisë dhe artizanatit, prodhimet e tyre etj.), tregtia etj.

Gjatë trajtimit të kushteve natyrore, vendin kryesor e zë trajtimi dhe përshkrimi i maleve e vargjeve malore më të mëdhenj dhe i fushave kryesore (fusha e Myzeqesë, Zadrimës, e Shkodrës, e Kosovës, etj.). Me hollësi trajtohen gjithashtu edhe lumenjtë e liqenet. Përshkruhen gati të gjithë lumenjtë, nga burojnë, territoret që përshkojnë, degët që marrin, ku derdhen, etj. Më gjatë trajtohet lumi Drin si lumi më i gjatë i vendit, pastaj Mati, Shkumbini e Vjosa. Për liqenet jepen gjatësia, gjerësia dhe sipërfaqja. Në të njëjtën mënyrë trajtohen të gjithë gjiret detare, gadishujt, kepet dhe limanet (portet - V.K.). Për të gjithë këta jepen karakteristikat e tyre. Gjatë trajtimit të limaneve (porteve - V.K.) në tekstet shprehet keqardhja se banorët e tyre nuk merren me lundrim. Kështu duke përshkruar gjirin e Butrintit në “Dheshkronjën” e S.Frashërit shkruhet: “*meng e Butrintit liman fort i bukur të cilit mund t’i bëhet një qytet i madh dhe me tregëti të shquar siç ka qenë edhe qëmoti*”⁹, kurse në librin “Shcypnia” shkruhet “*limanet e vendit tonë nuk kanë paisje dhe se megjithëse Shqipëria ka një breg të gjatë....., banorët e saj nuk merren me lundrim,*

⁸ Edhe në tekstin *Shcypnia* mungon emri i autorit ose autorëve.

⁹ S.Frashëri, *Dheshkroje*, f. 109.

*përveç ulqinakëve që kanë ardhur në Shkodër, mbasi qytetin e tyre e mori Mali i Zi*¹⁰.

Në “Dheshkronjën” e S.Frashërit e atë të G .Mikelit dhe në tekstin “Shcypnia” bëhet dhe rajonizimi klimatik e gjeografik i vendit tonë. Sipas tyre dallohen dy zona klimatike, të cilat S. Frashëri i ka quajtur: e para klimë e vendeve të larta që dallohet për klimë të mirë e të shëndetshme dhe e dyta klimë e vendeve të ulëta që nuk shohin borë dhe akull dhe me klimë jo të mirë. Nga ana gjeografike Shqipëria ndahet në dy pjesë të mëdha gjeografike: Gegëria për pjesën në veri të lumit Shkumbin dhe Toskëria në jug të tij. Sipas “Dheshkronjës” së S. Frashërit, Gegëria përbëhet nga 44 copa (krahina - V.K.) si Fusha e Kosovës, Podrima, Pllava, Hoti, Kelmendi, Hasi, Mirdita, etj. dhe Toskëria që përbëhet nga 25 copa si Labëria, Zagoria, Dangëllia, Deshnica, Mallakastra, Myzeqeja, Sulova, etj. Në tekstin “Shcypnia” krahinat për pjesën veriore emërtohen sipas fiseve që i banojnë, kurse në atë jugore përdoren emërtime gjeografike si dhe në “Dheshkronjën” e S.Frashërit.

Gjatë trajtimit të maleve, në “Dheshkronjën” e S.Frashërit përmenden 22 male e vargje malore, midis të cilëve: Alpet e Shqipërisë, malet e Sharit, mali i Korabit, malësia e Krrabës, malësia e Martaneshit, mali i Polisit, mali i Oparit, Tomorit e Sulova, Mallakastra e Trebeshina, mali i Gribës, Lungarës e malet e Bregdetit, mali i Nemërçkës, malet e Qarit, Gramozit e Moravës, etj.

Në dallim nga “Dheshkronja” e S.Frashërit në librin “Shcypnia” dhe në atë të G.Mikelit kemi një rajonizim e grupim tjetër të vargjeve malore. Sipas këtyre dy librave malet e vendit tonë grupohen në katër vargje. E rëndësishme është se në emërtimet e tyre, përdoren emërtime gjeografike, nga fillojnë e deri ku shtrihen, kush bën pjesë në ta dhe kush degëzohet prej tyre:

1- Alpet e Shqipërisë e Bjeshkët e Malsisë (sipas tekstit të G.Mikelit Bjeshkët e Shqipërisë së Epër), i cili shtrihet nga liqeni i Shkodrës deri në Fushë Kosovë prej JP në VL. Në ta bëjnë pjesë Veleçiku, Bjeshkët e Namuna, Shkëlzeni, Biga e Gimajve, etj.

2 - Vargu i Madh i Sharit me shtrirje jug-veri, ku bëjnë pjesë malet e Korabit, Gjalica e Lumës, etj.

3 - Vargu përkundrejt vargut të maleve të Sharit (sipas tekstit të G.Mikelit malet e Gegëve) që fillon në të majtë të Drinit të Zi (ku bashkohen të dy Drinët) deri në liqenin e Ohrit. Në të bëjnë pjesë mali i Shejtë, Deja, Jabllanica, etj. Prej tij degëzohen shumë krahë (përfshihen të gjithë vargjet e tjerë malorë të Krahinës Malore Qendrore shënim - V.K.).

4 - Vargu malor në lindje të liqenit të Ohrit deri në Pind, i cili ndan pjesën perëndimore prej pjesës lindore të Gadishullit të Ballkanit midis detit Egje e detit Jon. Ky varg përfshin malin e Galiçicës, Peristerin, Gramozin etj. Edhe

¹⁰ *Shcypnia*, Shkodër, 1902, f. 12-13.

nga ky varg degëzohen disa krahë (përfshihen të gjithë vargjet e tjerë të Krahinës Malore Jugore shënim - V.K.). Ky rajonizim në vija të përgjithshme përputhet me rajonizimin e sotëm gjeografik. Kështu vargu i parë përfshihet në Krahinën Malore Veriore. Vargu i dytë dhe i tretë përfshihen në Krahinën Malore Qendrore dhe vargu i katërt në Krahinën Malore Jugore.

Duke vazhduar për gjeografinë e vendit tonë, flitet me hollësi për popullsinë, për katër vilajetet, për qytetet, prodhimet bujqësore e blegtorale, për artizanatin, pasuritë nëntokësore, pyjet, etj. Sipas tyre sipërfaqja e vendit tonë ka qenë 75 mijë km² dhe popullsia 2 milion banorë (sipas tekstit të G.Mikelit 91,4 mijë km² dhe popullsia mbi 2 milion), nga të cilët 1,6 milion ishin shqiptar dhe pjesa tjetër vllahë, grekër e sllavë. Jepet gjithashtu dhe përbërja e popullsisë sipas besimeve fetare.

Gjatë trajtimit të vilajeteve, përshkruhen të gjithë qytetet me të gjitha veçoritë e tyre (ku shtrihen, popullsinë që kanë, rëndësia historike, rolin që kanë luajtur, shkollat e objektet e kultit, veprimtaria ekonomike që zhvillohej, etj.). Më gjatë flitet për ata qytete që janë nga më të vjetrit, që kanë vlera historike, që kanë aktivitet më të madh ekonomik dhe që kanë luajtur rol më të madh në jetën e vendit tonë, si p.sh për Shkodrën, Lezhën, Krujën, Durrësin, Prizrenin, Gjakovën, Korçën, etj. Të bie në sy fakti se në ta nuk bëhet vetëm një përshkrim i thjeshtë, por gjërat analizohen. Bëhen përpjekje që të jepen gjërat më të bukura e më të mira të qyteteve, por me keqardhje shprehet prapambetja dhe izolimi i tyre. Kështu në tekstin e G. Mikelit shkruhet: *“Shkodra është qytet i gjerë, i hapur, i bukur, i hijshëm, por mjerisht i izoluar dhe i vetmuar nga krejt Shqipëria, mbasi nuk ka rrugë që ta lidhë me qytetet e tjera. Jo vetëm kaq, por s’ka as udhë që ta lidhin me malet e katundet e veta Shkodra ka kisha e xhami të bukura”*¹¹..... Ndërsa në “Dheshkronjën” e S. Frashërit për Korçën me që ishte hapur Mësonjëtorja e Parë Shqipe shkruhet: *“Korça, një nga më të mëdhenjtë e qyteteve të Toskërisë dhe pranë një fushe të punuar fort mirë, me treg të mirë, me tregti të madhe, me mësonjëto të shumta e me 10 mijë njerëz, qytet që ditë më ditë po ndërtohet edhe i cili ka hedhur këmbën e parë në mësimin shqip”*¹².

Një vend të veçantë në tekstet e mësipërme zë trajtimi i ekonomisë dhe shkaqet e prapambetjes së saj. Në ta theksohet se bujqësia dhe blegtorja janë dy degët kryesorë që e mbajnë në këmbë Shqipërinë.

Në kapitujt për bujqësinë dhe kulturat bujqësore që mbilleshin, theksohet se tokat e Shqipërisë janë pjellore dhe se prodhojnë grurë, misër, elb, oriz, fasule, duhan, ullinj, rrush, arra, fiq, dardha, mollë, portokalle, limonj, etj. Në ta jepet njëkohësisht edhe përhapja gjeografike e kultivimit të tyre dhe kush dallohet për

¹¹ G. Mikeli, *Dheshkroje per msojtoje popullore e gjyettnore*, libri i parë, Shkodër, 1912, f. 136.

¹² S. Frashëri, *Dheshkroje*, f. 119.

kultivim e prodhim. Kështu shkruhet se për kultivimin e drithërave dhe prodhimin e shumtë të tyre dallohen fusha e Kosovës, Myzeqesë, e Korçës dhe e Prespës. Krahinat që nga Shkodra, Lezha, Kavaja, Elbasani, Vlora e deri në Prevezë janë të veshura me ullinj të shumtë e të mirë që japin shumë vaj. Për rritjen e prodhimin e duhanit dallohen Shkodra, Gjakova, Peja, Berati e Çamëria. Duhani është i mirë kudo dhe shitet në vendet fqinje e më larg. Po kështu flitet edhe për rrushin nga i cili nxirret verë e mirë. Edhe kulturat e drunjtat si dardhat, mollët, fiqtë, arat, etj., janë të shumtë si në vendet e ulëta dhe në ato të larta. Vëmendje u kushtohet dhe pyjeve duke theksuar se vendi ynë është i pasur me pyje të shumtë dhe se në ta rriten lloje të shumtë drurësh. Përsa i përket blegtorisë vihet në dukje se më e përhapur është blegtoria e imët (rritja e dhenve dhe e dhive). Më tepër me blegtori merret Veriu, Kurveleshi, lugina e Vjosës, Pogoni, malësorët e Tomorit, të Pindit etj. Nga blegtoria merret lesh e lëkura të shumta. Për shitjen e tyre jashtë vendit dallohen Shkodra, Janina, Përmeti, Vlora etj.

Një vlerësim dhe vëmendje bëhet edhe për pasuritë nëntokësore. Në to vihet në dukje se Shqipëria është e pasur në minerale, por askush nuk përkujdeset për to. Këtu përmendet nxjerrja e kripës në Kavajë si dhe sera e Selenicës që shfrytëzohej nga një shoqëri franceze. Përmendet gjithashtu ku kishte qymyr guri, bakër, hekur etj.

Përveç bujqësisë, blegtorisë dhe pasurive nëntokësore shumë gjerë trajtohet artizanati, transporti dhe tregtia. Përmenden të gjitha degët e artizanatit që ishin më të përhapura dhe që kishin traditë, mallrat që prodhoheshin dhe cilësia e tyre, qytetet ku prodhoheshin dhe që dalloheshin për llojet e artizanatit dhe produktet e artizanatit, etj. Midis të tjerave përmenden prodhimet prej ari, argjendi dhe hekuri të përgatitura nga artizanët e Gjakovës, Prizrenit e Pejës, prodhimet e meshinës në Janinë, Prizren e vende të tjera, prodhimet nga qëndistarët e Shkodrës, prodhimet e artizanëve të Dibrës, etj. Përmenden gjithashtu prodhimet prej shajaku, velenxave, shkorsave, pëlhurave të linjta, të pambukta, etj., të përhapura në të gjithë vendin. Për industrinë nuk bëhet fjalë mbasi praktikisht nuk ekzistonte. Duke analizuar gjendjen e industrisë në tekstin e G.Mikelit shkruhet: *“në krahasim me vendet e tjera nuk ka kurgjë.....Mund të përmendim mullinjtë avullorë dhe fabrikat e sapunit në Elbasan e Shkodër etj.”*¹³ Në tregtinë e vendit tonë me botën, prodhimet bujqësore, blegtorale dhe të artizanatit përbënin të vetmet mallra që shiteshin jashtë Shqipërisë. Më tepër tregtia bëhej me vendet fqinje (me Malin e Zi, Dalmacinë, Korfuzin, Selanikun, Triesten, Barin, Brindisin, etj.), gjithashtu dhe me vendet e Afrikës Veriore, me Austrinë, Marsejën (Francën) etj. Me

¹³ G. Mikeli, *Dheshkroje per msojtore*, f. 170.

keqardhje në këto tekste shprehet se mungesa e rrugëve, e pengonin zhvillimin ekonomik të vendit dhe lidhjen midis viseve dhe bërjen e tregtisë.

Duke analizuar zhvillimin ekonomik të vendit tonë, në të gjitha librat flitet me një admirim të madh për talentin e popullit shqiptar, për aftësitë që ai ka për të prodhuar e bërë gjëra të mira, për mallrat me cilësi të mirë që prodhonte e që pëlqeheshin edhe jashtë vendit, për aftësitë si detarë të zotë e të aftë për të bërë tregti edhe me vende të largëta, etj. Nga ana tjetër theksohet se megjithëse vendi ynë ka kushte natyrore të mira e pasuri natyrore të shumta dhe një popullsi të talentuar e të aftë të prodhojë gjëra të mira, gjendja ekonomike dhe niveli ekonomiko-shoqëror e kulturor është i ulët, për shkak të sundimit turk dhe se askush nuk përkujdeset për të. Kështu në “Dheshkronjën” e S.Frashërit shkruhet: “*Metale si hekur, bakër, thëngjill (qymyr guri - shënim V.K.), serë, etj., gjenden në Shqipëri, por edhe njeri s’përkujdeset.....*”¹⁴. *Po të hapen dhe qërohen moçalet (kënetat) nuk do të ketë klimë të ligët gjëkund në Shqipëri.....*”¹⁵. *Dituria është fort pas në Shqipëri se shkronjat shqip edhe s’janë përhapur në të gjitha anët e Shqipërisë dhe ca mësonjëtoje të pakta që gjenden nëpër qytete janë turqisht, greqisht e të tjera gjuhëra që s’i dinë Shqiptarët*”¹⁶, kurse në “Dheshkronjën” e G. Mikelit shkruhet: “*Për metale Shqipëria është shumë e pasur, por s’ka kush përkujdeset për to*”¹⁷, ndërsa në tekstin “Shcypnia” shkruhet se “*megjithëse tokat e Shqipërisë janë pjellore, ato kanë nevojë të përmirësohen, mbasi mbyten nga ujërat që vinë nga malet e kthehen në kënetat.....mungesa e rrugëve pengon shfrytëzimin e pyjeve që janë të pasur...*”

Duke u mbështetur nga sa përmendëm më lart për tekstet gjeografikë të përdorura gjatë kësaj periudhe, konstatojmë se ata dallohen për një gamë të gjerë njohurish gjeografike nga të gjitha fushat e gjeografisë dhe për të dhënat më të reja të kohës. Në ta janë dhënë ato dije gjeografike që janë më origjinale, më specifike, më të dallueshme dhe më të rëndësishmet e më të nevojshmet, të cilat ndihmonin në formimin gjeografik të nxënësve për botën në tërësi e vendin tonë në veçanti. Në ta gjithashtu shprehet qartë përhapja gjeografike e saktë e dukurive gjeografike dhe se pikëpamjet mbi botën kanë qenë materialiste. Materiali i paraqitur në ta është renditur në mënyrë funksionale ku njohuritë që jepen në fillim ndihmojnë për të kuptuar e shpjeguar dukuritë që trajtohen më pas. Mënyra e shtjellimit ndryshon sipas temave të mësimit dhe janë dhënë ato forma që kuptohen më mirë nga nxënësit. Ajo që ka më tepër rëndësi është niveli i lartë shkencor i teksteve. Ata (tekstet) dallohen për nivelin e lartë shkencor, për saktësinë shkencore dhe analizën shkencore të trajtimit të

¹⁴ S. Frashëri, *Dheshkroje*, f. 125.

¹⁵ *Po aty*, f. 124.

¹⁶ *Po aty*, f. 126.

¹⁷ G. Mikeli, *Dheshkroje per msojtore...*, f. 170.

dukurive gjeografike sipas pikëpamjeve të kohës duke bërë shpjegimet e nevojshme. Të gjitha dukuritë gjeografike në tekste trajtohen në evolucionin e tyre duke nxjerrë në pah lidhjet e tyre të ndërsjella, faktorët dhe shkaqet që veprojnë. Një trajtim i tillë ishte në përputhje të plotë me drejtimit e reja gjeografike, e cila nga gjysma e dytë e shek. XIX, po kalonte nga një shkencë përshkruese në një shkencë sqaruese duke vënë theksin në shkaqet dhe faktorët. Pra nxënësit e shkollave tona kombëtare shqipe merrnin kështu njohuritë dhe konceptet më të reja gjeografike, ato më përparimtare. Ky fakt tregon gjithashtu për një nivel të lartë të arsimit gjeografik të nxënësve në shkollat shqipe (për njohuritë gjeografike, nivelin shkencor e metodik) që mund të krahasohet me nivelet e shkollave të vendeve të përparuara.

Përsa i përket gjeografisë së vendit tonë ajo është trajtuar në të gjitha aspektet e saj, natyrore, ekonomike, politike, etj. Gjendja ekonomike trajtohet në tërë kompleksitetin e saj. Në të dalin qartë, cilat kanë qenë degët bazë të ekonomisë, cilat kanë qenë kulturat bujqësore më të përhapura e prodhimet bujqësore e blektorale më të rëndësishme, cilat kanë qenë prodhimet e artizanatit e cilët qytete dalloheshin në këtë drejtim, etj. Po kështu pasqyrohet prapambetja ekonomike e niveli arsimor e kulturor i ulët, etj., dhe shkaqet e kësaj gjendjeje si pasojë e pushtimit turk dhe të mos përkujdesen për zhvillimin e vendit tonë.

Të bie në sy dëshira dhe qëllimi i autorëve, që gjeografia e vendit tonë të njihej sa më mirë nga nxënësit duke ngjallur tek ata frymën patriotike dhe ndjenjën e dashurisë për vendin e tyre. Kështu në “Dheshkronjën” e S.Frashërit që në fillim të kapitullit për Shqipërinë shkruhet: *“Shqipëria me që është vendi ynë, kemi nevojë ta dimë më mirë se çdo vend, prandaj do ta tregojmë këtu veçan më gjatë”*¹⁸. Gjithashtu shkruhet me një patos, admirim e ndjenjë patriotizmi dhe me një dashuri të madhe për natyrën e vendit tonë, për bukuritë e pasuritë natyrore të saj, për qytetet, popullsinë, për aftësitë e popullit shqiptar etj. Midis të tjerave në “Dheshkronjën” e S.Frashërit shkruhet: *“Shqipëria është një nga më të bukurat e vendeve të Ballkanit, me male të lartë, me fusha të gjera, me anë deti, me mëngë(gjire) e limane të shumtë, me lumenj e liqene të bukura”*.....¹⁹ kurse në “Dheshkronjën” e G.Mikelit shkruhet: *“Shqipëria është një dhe fort i bukur, ka bjeshkë të blerta të veshura në shumë vise me pyje, fusha pjellore si dhe lumenj e liqene që e përshkojnë dhe e tërthurin këtë dhe në të tëra anët”*²⁰.

Gjatë trajtimit të natyrës shqiptare në të gjithë tekstet bëhen përpjekje për të dhënë atë që është më e mirë, më e bukur dhe më karakteristike. Tekstet e lartpërmendur kanë luajtur rol të madh në njohjen e gjeografisë së vendit tonë

¹⁸ S. Frashëri, *Dheshkroje*, f. 105

¹⁹ *Po aty*, f. 105-106.

²⁰ G.Mikeli, *Dheshkroje per msojtore...*, f. 125.

dhe në edukimin patriotik të nxënësve. Asnjëherë për gjeografinë e vendit tonë nuk ish shkruar kaq gjatë, me kaq hollësi dhe në mënyrë komplekse sa në tekstet e lartpërmendur. Nëpërmjet këtyre teksteve nxënësit mundën të mësojnë gjeografinë e vërtetë të vendit tonë dhe gjendjen reale të tij. Nëpërmjet tyre nxënësit mundën të mësonin trojet e vërteta shqiptare, qytetet që bënin pjesë, popullsinë që banonte, natyrën shqiptare dhe mundësitë që ajo ofronte, gjendjen ekonomike dhe shkaqet e kësaj gjendjeje, etj. Studimi i gjeografisë së Shqipërisë ngjallte tek nxënësit gjithnjë e më tepër ndjenjën e patriotizmit dhe të dashurisë për vendin tonë Shqipërinë. Këta tekste kanë luajtur rol të madh edhe gjuhësor. Ata përshkohen nga një terminologji gjeografike shqipe e kulluar dhe është përdorur gjuha popullore. Terminologjia gjeografike është e tëra shqip. Termat gjeografike janë zgjedhur nga gjuha e përditshme. Mjaft të goditura janë termat gjeografikë “hell” (për boshtin e Tokës), “mesditës”(për meridian), “çip”(për kepin), “gjelbërore” (për oaze), etj. Për hartuesit e teksteve të gjeografisë si dhe për gjithë rilindësit pasurimi dhe kultivimi i gjuhës shqipe dhe ruajtja e pastërtisë së saj ka qenë një nga qëllimet dhe objektivat kryesore të tyre gjatë hartimit të teksteve shkollorë. Prandaj edhe në vend të fjalës “gjeografi” ata kanë përdorur temin “Dheshkronja”, për astronominë “QIELLSHKRONJA” e kështu me radhë. Për të gjitha sa përmendëm për nivelin e lartë shkencor, metodik, gjuhësor e patriotik të teksteve, mund të arrijmë në përfundim se arsimimi gjeografik në shkollat shqipe në këtë periudhë ishte vënë në baza të shëndosha dhe se këto tekste kanë ndikuar jo vetëm në ngritjen e nivelit shkencor të gjeografisë në shkollë, por përbëjnë dhe një kontribut të mirë në zhvillim e gjeografisë në vendin tonë, e në veçanti të gjeografisë shkollorë dhe në mendimin gjeografik shqiptar.